

# RAPORTI VJETOR 2019

*Prioritetet e Institucionit për vitin 2020*

**Përmbledhje Ekzekutive**



**AUTORITETI I  
KONKURRENCËS**



“

***Mendoj se konkurrenca e drejtë është jo vetëm një nga themelet e Bashkimit Evropian, por edhe të tregëtisë së lirë.***

*—Margrethe Vestager  
Komisioner për Konkurrencën*

”

# PËRMBAJTJA

- 04 30" PËR T'U NJOHUR ME  
AUTORITETIN
- 06 STATISTIKA
- 09 FJALA E KRYETARIT TË  
KOMISIONIT TË  
KONKURENCËS
- 10 LEGJISLACIONI SEKONDAR
- 11 TREGJET E MONITORUARA
- 12 PROCEDURAT HETIMORE
- 18 PËRQENDRIMET
- 20 TË DREJTAT EKSKLUZIVE
- 21 AK PËRBALLË PROCESIVE  
GJYQËSORE
- 22 ADVOKACIA E  
KONKURENCËS
- 23 BASHKËPUNIMI  
NDËRKOMBËTAR
- 24 INTEGRIMI EVROPIAN
- 25 KAPACITETE NJERËZORE
- 26 PRIORITETET 2020

# MISIONI

Hetimi i sjelljeve antikonkurrese

Kontrolli i përqendrimeve

Vlerësimi i të drejtave ekskluzive

Advokaci e kulturës së konkurrencës

30''

STATUSI *Institucion*

*Publik i*

*Pavarur*

**5** Komisionerë

**46** Punonjës

**55** Ditë trajnimi  
për punonjësit

### 03 prill 2019

Rezoluta e Kuvendit të Shqipërisë për vlerësimin e veprimtarisë së AK për vitin 2018

### 26 qershor 2019

Miratimi i Udhëzuesit “Mbi dëmet që shkaktohen dhe veprimet që ndërmerren kur shkelen dispozitat e Ligjit nr. 9121”

### 4 korrik 2019

Miratimi i “Kornizës së Procedurave të Autoritetit të Konkurrencës” në kuadër të Rrjetit Ndërkombëtar të Konkurrencës

### 14 nëntor 2019

15 vjetori i Autoritetit të Konkurrencës  
Konferenca “Konkurrenca dhe Sipërmarrjet”  
Lançimi i Projektit të Binjakëzimit IPA

### 25 dhjetor 2019

Rregullore “Për parandalimin e konfliktit të interesave dhe për deklarimin e pasurive në ushtrimin e funksioneve publike në AK”

### 28 janar 2019

KK vendosi marrjen e masave të përkohshme në tregun e ofrimit të shërbimeve stomatologjike ndaj Urdhrit të Stomatologut të Shqipërisë

### 31 janar 2019

KK vendosi hapjen e procedurës së hetimit të thelluar në sektorin bankar për Bankën Raiffeisen, Bankën Kombëtare Tregtare, Bankën Credins dhe Bankën Intesa SanPaolo

### 31 korrik 2019

Mbyllja e hetimit paraprak në tregun e depozitimit dhe devijimit të energjisë elektrike dhe dhënia e detyrimeve për ndërmarrjen KESH SHA

### 10 tetor 2019

KK vendosi hapjen e procedurës së hetimit të thelluar ndaj ndërmarrjes Bankers Petroleum Albania Ltd në tregun e prodhimit dhe tregimit të naftës bruto

### 24 dhjetor 2019

KK vendosi t'u japë disa rekomandime:

- Ministrisë së Drejtësisë
- Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë
- Dhomës së Avokatisë
- Dhomës Kombëtare të Noterëve
- Shoqatës së Vlerësuesve të Pasurive

lidhur me profesionin e avokatit, noterit dhe vlerësuesit të dëmeve.

për t'u njohur me

**AUTORITETIN**

TË ARDHURA

**12.5**

milionë Lekë


Të ardhura të realizuara nga autorizimi i përqendrimeve

BUXHETI


**77.9**

milionë Lekë


Buxheti për vitin 2019




Numri i vendimeve në vite




Procedura hetimore në vite



Autorizimet e përqendrimeve



### Vendime të marra gjatë vitit 2019



### Tregjet joprodhuese të hetuara gjatë vitit 2019



### Tregjet prodhuese të hetuara gjatë vitit 2019





# FJALA E KRYETARIT TË KOMISIONIT TË KONKURRENCËS

Viti 2019 përbën një tjetër vit sfidues për ekonominë, tregjet, autoritetet dhe institucionet në Shqipëri. Nga ky prizëm, zhvillimet komplekse, ndikuan dhe orientuan edhe aktivitetin e Autoritetit të Konkurrencës, në përpjekjet e tij për të përmbushur me sukses përgjegjësitë ligjore të tij. Njësoj si më parë, në qendër të veprimtarisë së tij ka qenë funksionimi i tregjeve në mënyrë të lirë, të hapur, ku pjesëmarrësit respektojnë parimet e konkurrencës në dobi të rritjes ekonomike dhe mirëqenies së popullatës.

Konkurrenca e lirë përbën një nga shtyllat kryesore, që garanton epërsinë e ekonomisë së tregut. Në kuptimin figurativ, nëse tregu është i lirë dhe konkurrues, atëherë gara mes lojtarëve është e ndershme. Por jo vetëm. Ajo garanton efektivitet maksimal në përdorimin e kapitalit, fuqisë punëtore, kapaciteteve prodhuese dhe burimeve natyrore.


Mbështetur në këto parime thelbësore të veprimtarisë sonë, Autoriteti i Konkurrencës për gjatë gjithë vitit 2019, bazuar në prioritetet e tij, në problematika të caktuara të momentit, në sinjalizime të ngritura në media apo në rrugë të tjera komunikimi, në ankesa të qytetareve dhe të bizneseve ka monitoruar dhe hetuar në vazhdimësi segmente të caktuara të tregut. Më konkretisht gjatë vitit 2019 Autoriteti ka realizuar:

- 15 (pesëmbëdhjetë) procedura monitorimi, nga ku veçojmë tregun e depozitimit dhe të devijimit të energjisë elektrike, tregun e transportit ajror, tregun e prokurimeve të rojeve fizike, tregun e sigurimeve, tregun e bankave dhe tregun e shërbimeve celulare.
- 11 (njëmbëdhjetë) procedura hetimore, nga ku veçojmë tregun e shërbimeve bankare, tregun e mbushjes-zbrazjes në Portin e Durrësit, tregun e shërbimit stomatologjik, tregun e naftës bruto, tregun e miellit, tregun e taksive dhe tregun e energjisë.

E gjithë veprimtaria monitoruese dhe hetuese e Autoritetit është realizuar në përmbushje të vendimmarrjes së Komisionit të Konkurrencës, organit vendimmarrës të institucionit. Me konkretisht, janë marrë 93 (nëntëdhjet e tre) vendime të Komisionit të Konkurrencës nga të cilat:

- 24 (njëzetë e katër) janë autorizime për përqendrim, nga të cilat 8 në tregun e brendshëm dhe 16 në tregun e jashtëm;
- 45 (dyzetë e pesë) vlerësime ligjore që lidhen me situatën në tregun e energjisë elektrike, të ujit, të telefonisë, të sektorit financiar e në shumë segmente të tjera.

Gjatë vitit 2019, Autoriteti ka derdhur në buxhetin e shtetit shumën 12,583,318 lekë, e cila është derdhur si e ardhur nga përqendrimet (njoftim dhe autorizim përqendrimi), çka përbën 17% të buxhetit të Institucionit.



Viti 2020 përkon me një tjetër periudhë komplekse. Ekonomia shqiptare, do të përballet me një tjetër vit sfidues ku ndërmjet të tjerash i duhet të rikuperojë edhe dëmet e shkaktuara nga tërmeti i fund vitit të kaluar. Nga ky këndvështrim, Autoriteti i Konkurrencës zotëron gjithë potencialin njerëzor për të përballuar të gjithë sfidat dhe për të përmbushur të gjithë objektivat ligjore të tij. Njësoj si në të kaluarën edhe gjatë këtij viti veprimtaria jonë do të synojë mbrojtjen e konkurrencës në të tre shtyllat e përcaktuara në ligj:

- Shmangien e marrëveshjeve të ndaluara (kartelet);
- Shmangien e abuzimit me pozitën dominuese;
- Kontrollit të bashkimeve ose përqendrimeve të ndërmarrjeve.

Në vazhdimësi Autoriteti do të jetë jo vetëm nxitës, por njëkohësisht do të jetë edhe avokat i konkurrencës dhe i interesave të konsumatorit.

Ju faleminderit,

# Legjislacioni sekondar

## AKTE TË MIRATUARA NË KUADËR TË ZBATIMIT TË PKIE - 2019

### Udhëzimi nr. 3, datë 26.06.2019 “Mbi dëmet që shkaktohen dhe veprimet që ndërmerren kur shkelen dispozitat e ligjit 9121/2003”

Udhëzimi synon përcaktimin e rregullave të nevojshme për të siguruar mundësinë e ushtrimit në mënyrë efektive të të drejtës për të kërkuar kompensim, nga një ndërmarrje apo grup ndërmarrjesh, lidhur me dëmet e pësuar nga çdo person fizik apo juridik të cilat rrjedhin nga shkelja e ligjit të konkurrencës.

Udhëzuesi përcakton rregullat që nxisin konkurrencën e lirë dhe efektive në treg dhe heqjen e pengesave për funksionimin e duhur të saj, duke siguruar mbrojtje të lirë dhe efektive në gjithë territorin e RSH, për të gjithë ata që kanë pësuar një dëm të tillë.

## AKTE TË MIRATUARA NË KUADËR TË ZBATIMIT TË ICN (RRJETIT NDËRKOMBËTAR TË KONKURRENCËS)

Korniza përbën një set rregullash ligjore në lidhje me ndjekjen e procedurave të drejta në proceset hetimore dhe të zbatimit të ligjit të konkurrencës, nga të gjitha Autoritetet e Konkurrencës anëtare të ICN.



International  
Competition  
Network

Ajo përcakton kryesisht parimet që rrjeti i ICN ndjek në përputhje me punën në grupe ndërmjet Autoriteteve të Konkurrencës pjesë e rrjetit si dhe në fushën e politikës së konkurrencës, duke reflektuar gjithnjë konsensusin e gjerë brenda komunitetit global të konkurrencës.


## AKTE TË TJERA TË MIRATUARA NË ZBATIM TË LIGJIT NR. 9121/2003 “PËR MBROJTJEN E KONKURRENCËS”, I NDRYSHUAR

### Rregullore “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë AK”

Qëllimi i rregullores është reflektimi i eksperiencave të Autoriteteve homologe të vendeve evropiane por edhe të agjencive të konkurrencës në rajon.

### Rregullore “Për parandalimin e konfliktit të interesave dhe për deklarimin e pasurive në ushtrimin e funksioneve publike në AK”

Qëllimi i rregullores është garantimi i një vendimmarrjeje të paanshme, transparente, në interesin më të mirë të mundshëm të publikut e të besimit të tij nga zyrtarët e Autoritetit të Konkurrencës, nëpërmjet parandalimit të konfliktit ndërmjet interesave publikë dhe atyre privatë në ushtrimin e funksioneve në Autoritetin e Konkurrencës.



# Tregjet e monitoruara

Autoriteti i Konkurrencës, në zbatim të nenit 28 të ligjit nr. 9121/2003, realizon monitorime dhe analiza të tregjeve, me qëllim zhvillimin e konkurrencës së lirë dhe efektive.

Nëpërmjet monitorimeve vlerësohen elementë konkurrues siç janë: strukturat e tregut dhe dinamikat e zhvillimit të tij, sjellja e ndërmarrjeve në treg në lidhje me konkurrentët e tjerë, konsumatorët, si dhe barrierat ligjore dhe ekonomike për hyrësit e rinj në treg.



**Tregu financiar**  
(sigurime dhe banka)

Ngarkim-shkarkimi  
në Terminalin Lindor Durrës



**Tregu i hidrokarbureve**

Transporti  
(ajror, detar dhe tokësor)



**Tregu i sigurimeve**

Shërbimet spitalore



**Prokurimet**

Telefonia celulare



**Energjia**

Rrjetet e supermarketeve  
Conad



**Pula**

Mielli



**Tregu i Depozimit të Energjisë**

Tregu agro-ushqimor



# Procedura hetimore

## Hetim paraprak në tregun e depozitimit dhe devijimit të energjisë elektrike

KK, me vendimin nr. 644, datë 31.07.2019, “Për mbylljen e hetimit paraprak në tregun e depozitimit dhe devijimit të energjisë elektrike, dhënien e detyrimeve për ndërmarrjen KESH SHA si dhe zbatimin e neneve 69 dhe 70 të Ligjit nr.9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar”, vendosi:

- Konstatimin e shkeljes së rregullave të konkurrencës që rrjedhin nga pozita dominuese e KESH, në drejtim të procedurave për lidhjen dhe zbatimin e:
  - a. Kontratës së devijimit të energjisë elektrike mes shoqërive KESH SHA dhe GSA SHPK.
  - b. Kontratës së depozitimit të energjisë elektrike mes shoqërive KESH SHA me EFT AG.
- Dhënien e detyrimeve për ndërmarrjen KESH SHA:
  - a. Detyrimin e ndërmarrjes KESH SHA në zbatim të Vendimin nr. 93/2019 të ERE të ndërpresë vazhdimësinë e këtyre dy kontratave.
  - b. Detyrimin e ndërmarrjes KESH SHA të njoftojë Sekretariatit e Energjisë në Vjenë për ecurinë e zbatimit të vendimit nr. 93/2019 të ERE.
  - c. Detyrimin e ndërmarrjes KESH SHA të njoftojë Autoritetin e Konkurrencës për ecurinë e zbatimit të vendimit nr. 93/2019 të ERE.
  - d. Detyrimin e ndërmarrjes KESH SHA, si operator me pozitë dominuese, për çdo kontratë të ardhshme, e cila vendos të drejta të veçanta ose ekskluzive, për ndërmarrje (kompani) ose për produkte te caktuara, të kërkojë një vlerësim paraprak nga Komisioni i Konkurrencës.
- Monitorimin e zbatimit të këtij vendimi, për një periudhë 1 vjeçare.



## Hetim i Thelluar në sektorin Bankar

Komisioni i Konkurrencës me vendimin nr. 592, datë 31.01.2019 vendosi hapjen e procedurës së hetimit të thelluar ndaj ndërmarrjeve: Banka Raiffeisen, Banka Kombëtare Tregtare, Banka Credins dhe Banka Intesa San Paolo, në tregjet e:

- depozitave
- kredive
- transfertave bankare

Ky hetim do të realizohet pas gjetjeve të hetimit paraprak të hapur me vendimin nr. 516, datë 22.05.2018, nga ku u konstatua se për këto 4 banka ka:

- qëndrueshmëri të pjesëve të tregut lidhur me depozitat dhe kreditë, shkallë të lartë përqendrimi në segmente të produkteve,
- norma shumë të ulëta dhe të ngurtësuara të interesave të depozitave,
- norma të larta të interesit të kredive,
- *spread* disa herë më i lartë krahasuar me normën e interesit të depozitave,
- komisione dhe penalitete bankare të larta për ndërrimin e bankës,
- komisione të larta për transfertat bankare në monedhë të huaj,
- norma të larta fitimi.

Objekti i hetimit të thelluar do të jetë vlerësimi i sjelljes së këtyre 4 bankave kryesore sipas klasifikimit të bërë nga Banka e Shqipërisë, në lidhje me komisionet dhe normat e interesave për tregjet objekt hetimi.



# Procedura hetimore

## Tregu i Profesioneve të Lira

KK me vendimin nr. 574, datë 26.11.2018, vendosi hapjen e Hetimit të Përgjithshëm në Tregun e Profesioneve të Lira (shërbimet e noterisë, avokatisë dhe vlerësuesve të pasurive të paluajtshme) pasi si treg i rregulluar, mund të paraqesë kufizime në hyrjen dhe sjelljen profesionale.

KK me vendimin nr. 668, datë 24.12.2019 “Për dhënien e disa rekomandimeve lidhur me ushtrimin e profesionit të avokatit, noterit dhe vlerësuesve të pasurive të paluajtshme” vendosi të rekomandojë si më poshtë:

Ministria e Drejtësisë,

- Të plotësojë kuadrin nënligjor përkatës në fushën e avokatisë dhe noterisë;
- Të dërgojë për vlerësim draft-aktet nënligjore pranë AK, të shoqëruara me relacionet përkatëse dhe me metodologji përlllogaritëse në rastet kur përcaktohen tarifa;
- Të merret në konsideratë mundësia lidhur me unifikimin e përmasave të tabelave, llojit të shkrimit, vetë ngjyrës së tabelës duke ofruar të njëjtin perceptim për konsumatorët dhe pa manipuluar zgjedhjen konsumatore kur të draftohet urdhri i ri “Për kushtet minimale që duhet të plotësojë një zyrë noteriale për të mundësuar ushtrimin normal të veprimtarisë së noterit”

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë,

- Të rishikojë kuadrin ligjor ekzistues duke parashikuar dispozita ligjore për organizimin dhe funksionimin e SVP
- Të dërgojë për vlerësim draft-aktet nënligjore pranë AK, të shoqëruara me relacionet përkatëse si dhe me metodologji përlllogaritëse në rastet kur përcaktohen tarifa

Dhoma e Avokatisë,

- Të mundësojë pasqyrimin në faqen e saj dhe të shfaqë të gjithë informacionin e nevojshëm, duke përfshirë informacion mbi trajnimet të cilat duhen ofruar prej saj

Dhoma Kombëtare e Noterëve,


- Të ofrojë asistencën e duhur noterëve lidhur me trajnime të vazhdueshme dhe kualifikime

Shoqata e Vlerësuesve të Pasurive,

- Të forcojë rolin e saj, si kusht për rritjen e cilësisë së shërbimeve të vlerësimit, vendosjen e kontakteve me organizata e shoqata të së njëjtës natyrë dhe shkëmbimi i përvojës me ta; hartimi dhe zbatimi i politikave që synojnë ngritjen profesionale

Bankat e nivelit të dytë.

- Të bëjnë transparent procesin e përzgjedhjes së vlerësuesve të dëmeve dhe të zbatojnë parimet e prokurimit publik





## Tregu i Shërbimit të transportit rrugor të udhëtarëve me taksi (4+1 vende) në qytetin e Tiranës

KK me vendimin nr. 609, datë 10.04.2019, vendosi hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e shërbimit të transportit rrugor të udhëtarëve me taksi (4+1 vende) në qytetin e Tiranës.

Nëpërmjet vendimit nr. 667, datë 24.12.2019, “Për mbylljen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e shërbimit të transportit rrugor të udhëtarëve me taksi (4+1 vende) në qytetin e Tiranës dhe dhënia e disa rekomandimeve”, KK vendosi:

- T’i rekomandojë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Ministrisë së Financave të rishikojë dhe përditësojë Udhëzimin e përbashkët të Ministrisë së Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit dhe Ministrisë së Financave (sot Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Ministria e Financave), nr. 1726/3, datë 21.04.2008 “Për caktimin e çmimeve dhe tarifave në shërbimin taksi” dhe unifikimin e të gjitha akteve që dalin në zbatim të këtij udhëzimi.
- T’i rekomandojë Bashkisë Tiranë:
  - a. Respektimin e hierarkisë së akteve normative, pas rishikimit dhe përditësimit të udhëzimit nga MIE dhe MF, duke qenë se Këshilli bashkiak përcakton nivelet e diferencuara të çmimeve dhe të tarifave brenda juridiksionit të vet, në përputhje me udhëzimin e përbashkët të Ministrisë së Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit dhe Ministrisë së Financave.
  - b. të kryejë verifikimin e subjekteve transportuese të licensuar në shërbimin taksi, duke bërë transparente në faqen zyrtare listën e të licensuarve dhe të regjistruarve pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë dhe Kalibrimit (DPMK) dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve.
- T’i rekomandojë Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë dhe Kalibrimit (DPMK) të kryejë plumbosjen e taksimetrit sipas tarifës së përcaktuar nga Vendimi i Këshillit Bashkiak për të gjithë ndërmarrjet e licensuara që operojnë në tregun e taksive të shoqëruar me numrin e serisë për çdo të licensuar dhe verifikimin e tyre periodik (brenda vitit).



# Procedura hetimore

## Tregu i ofrimit të shërbimeve stomatologjike

KK me vendimin nr. 586, datë 28.01.2019, vendosi hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e ofrimit të shërbimeve stomatologjike, për të parë nëse ka ose jo shenja të kufizimit apo shtrebbërimit të dispozitave të ligjit nr. 9121/2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar.

Vendim nr. 599, datë 15.03.2019 “Për mbylljen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e ofrimit të shërbimeve stomatologjike dhe dhënien e disa rekomandimeve”

- T'i rekomandojë Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale që:
  - a. Në respektim të nenit 69 dhe 70 të ligjit, të kërkojnë vlerësimin e Autoritetit të Konkurrencës për çdo projekt akt normativ i cili mund të sjellë kufizime sasiore për hyrjen në treg dhe tregtimin; që synon vendosjen e të drejtave ekskluzive ose të drejtave të veçanta në zona të caktuara, për ndërmarrje ose për produkte të caktuara; apo projekt akte normative të cilat imponojnë praktika të njëjta në çmime dhe kushte të shitjes;
  - b. Të kërkojë paraprakisht mendimin e Autoritetit të Konkurrencës në rastet kur parashikohen të përcaktohen metodologji të përcaktimit të tarifave apo rishikime të tarifave në shërbimin stomatologjik;
  - c. Tarifat që i ofrohen konsumatorëve në shërbimin stomatologjik, duhet të jenë të orientuara drejt kostos.
- T'i rekomandojë Urdhrit të Stomatologut që:
  - a. Në rastet e marrjes së vendimeve nga organet drejtuese të Urdhrit të Stomatologut, në lidhje me aspekte të ndryshme të cilat prekin konkurrencën në treg, me qëllim mbrojtjen e konkurrencës së lirë dhe efektive, të respektohen dispozitat e Ligjit 9121/2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar.





## Tregu i prodhimit dhe tregtimit të naftës bruto



“Për hapjen e procedurës së hetimit të thelluar ndaj ndërmarrjes Bankers Petroleum Albania Ltd në tregun e prodhimit dhe tregtimit të naftës bruto”

KK, me vendimin nr. 652, datë 10.10.2019 “Për hapjen e procedurës së hetimit të thelluar ndaj ndërmarrjes Bankers Petroleum Albania Ltd në tregun e prodhimit dhe tregtimit të naftës bruto”, vendosi hapjen e procedurës së hetimit të thelluar ndaj ndërmarrjes Bankers Petroleum Albania LTD në tregun e prodhimit dhe tregtimit të naftës bruto, për periudhën kohore nga 1 janari 2016 deri në 31 tetor 2019.



Procedura hetimore do të vazhdojë edhe gjatë vitit 2020, në respektim të afateve procedurale të ligjit 9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar, si dhe të Vendimit nr. 652, datë 10.10.2019.



# Kontrolli i përqendrimeve

## **Balfin SHPK/Komercialjalna Banka AD Skopje/ Tirana Bank SHA**

KK, me vendimin nr. 580, datë 17.01.2019 “Mbi përfitim të kontrollit nëpërmjet shitblerjes së 98,83% të aksioneve të Tirana Bank SHA nga Piraeus Bank SA tek Balfin SHPK dhe Komercialjalna Banka AD Skopje” vendosi të autorizojë përqendrimin.



## **Besniku SHPK/Atlas Mills SHPK**

KK, me vendimin nr. 622, datë 13.05.2019 “Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet blerjes së 100% të kuotave të shoqërisë Atlas Mills SHPK nga shoqëria Besniku SHPK” vendosi të autorizojë këtë përqendrim, pasi transaksioni i synuar nuk do të sjellë ndryshime domethënëse në tregun shqiptar. Pjesa e kombinuar e tregut pas përqendrimit nuk krijon shqetësime për konkurrencën në treg.



## **Telekom Albania SHA/Albania Telecom Invest AD**

KK, me vendimin nr. 610, datë 10.04.2019 “Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfitim të kontrollit të shoqërisë Telekom Albania SHA nga shoqëria Albania Telecom Invest AD” vendosi të autorizojë këtë përqendrim, pasi u konstatua se transaksioni nuk do të ndikojë në krijimin apo forcimin e pozitës dominuese në treg të shoqërisë Telecom Albania SHA.



## **Albanian Telecommunications Union SHPK/Digicom SHPK**

KK, me vendimin nr. 621, datë 13.05.2019 “Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfitim të kontrollit të shoqërisë Digicom SHPK nga shoqëria Albanian Telecommunications Union SHPK” vendosi të autorizojë këtë përqendrim, pasi u konstatua se ky përqendrim nuk shfaq shenja të kufizimit të konkurrencës në treg ose në një pjesë të tij në veçanti, si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese.





- Mjete motorike dhe pjesë këmbimi
- Media/Transmetim/Argëtim
- Tregu me pakicë (cigare, ushqimore, produkte të kujdesit personal, produkte higjene, etj.)
- Tregu financiar dhe i sigurimeve
- Hidrokarbure
- Infrastruktura dhe shërbime të transportit ajror
- Telekomunikacion
- Paisje elektronike dhe softë
- Të tjera (edukim; qira; shërbime shëndetësore & spitalore; transport hekurudhor, call centera, etj)


### Transaksione në tregun e jashtëm

1. KK, me vendimin nr. 529, datë 25.06.2018 “Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërisë ALH Group SHPK nga shoqëria Lufthansa Industry Solutions AS GmbH” vendosi të autorizojë këtë transaksion. Treg përkatës në këtë transaksion u konsiderua tregu i importit, shitjes me shumicë dhe pakicë të artikujve sportivë.

2. KK, me vendimin nr. 616, datë 02.05.2019, “Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet krijimit të një ndërmarrje të përbashkët, me funksione të plota (Joint Venture) nga shoqëritë Rockwell Automation Diamond Holdings Inc., Rockwell Automation Diamond Foreign Holdings Inc., Schlumberger Technology Corporation, Cameron International Corporation dhe Schlumberger B.V.”, vendosi të autorizojë këtë përqendrim pasi nuk do të krijojë mbivendosje ose marrëdhënie të rrjedhës së sipërme apo të poshtme midis aktiviteteve të palëve në nivel kombëtar.

3. KK, me vendimin nr. 663, datë 03.12.2019 “Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërisë Avon Products, Inc nga shoqëria Natura Cosméticos S.A” vendosi të autorizojë këtë transaksion. Treg përkatës i produktit në këtë transaksion mund të konsiderohet tregu i produkteve të bukurisë dhe produkteve të lidhura me to, por duke marrë në konsideratë natyrën e transaksionit, si edhe duke iu referuar praktikave të Komisionit Evropian në çështje të ngjashme, tregu përkatës mund të lihet i hapur.

4. KK, me vendimin nr. 624, datë 31.05.2019 “Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërisë Saudi Basic Industries Corporation nga shoqëria Saudi Arabian Oil Company” vendosi të autorizojë këtë transaksion pasi nuk do të krijojë mbivendosje ose marrëdhënie të rrjedhës së sipërme apo të poshtme midis aktiviteteve të palëve në nivel kombëtar.




# Të drejtat ekskluzive

## **Tregu i organizimit dhe administrimit i aktivitetit të futbollit, dhe aktivitetet ekonomike të përfshira si shitja nga një njësi e vetme që zotëron të drejtat ekskluzive**

KK, me vendimin nr. 607, datë 01.04.2019 vendosi hapjen e procedurës së hetimit të thelluar ndaj Federatës Shqiptare të Futbollit.

Drejtorja e Përgjithshme për Konkurrencën e Komisionit Evropian, ndër 13 sektorët më të rëndësishëm, trajton edhe Sektorin e Sportit, i cili ka një rëndësi të madhe dhe ndikim të konsiderueshëm ekonomik në çdo vend edhe në BE, për biznesin që bën për të drejtat e transmetimit, veçanërisht për TV, duke u bërë shumë fitimprurëse.

Gjykata Evropiane e Drejtësisë vendosi që përderisa veprimtaria e kryer është një veprimtari ekonomike, e cila është e pamohueshme për sportet, ajo bie nën rregullat e neneve 101 dhe 102 të Traktatit (TFEU), prandaj dispozitat e konkurrencës duhen aplikuar.



## **Tregu i depozitimit dhe devijimit të energjisë elektrike**

KK, me vendimin nr. 588, datë 28.01.2019 vendosi hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e depozitimit dhe devijimit të energjisë elektrike, për të parë nëse ka ose jo shenja të kufizimit apo shtrembërimit të dispozitave të ligjit nr. 9121/2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar.

## **Tregu i ofrimit të shërbimit të ruajtjes dhe sigurimit të objekteve shtetërore**

KK, me vendimin nr. 640, datë 25.07.2019, vendosi t'i japë disa rekomandime Shoqërisë “Illyrian Guard” SHA lidhur me ushtrimin e aktivitetit të saj.



# AK përballë proçeseve gjyqësore

## Çështje të gjykuara në Gjykatën Administrative të Shkallës së parë

Në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë përgjatë vitit 2019 është shqyrtuar 1 (një) çështje.

Çështja Gjyqësore me:

Paditës: shoqëria "Conad Albania" sh.p.k.

Të paditur: Autoriteti i Konkurrencës

Objekti: Shfuqizimi i vendimit nr. 560, datë 15.10.2018 të KK "Për mbylljen e procedurës së hetimit paraprak ndaj ndërmarrjes Conad Albania SHPK në tregun e tregimit të produkteve ushqimore të cilat mbartin markën "Conad" në Republikën e Shqipërisë dhe vendosjen e disa detyrimeve".

**Gjykata Administrative e Shkallës së Parë e rrëzoi kërkesë padinë e shoqërisë "Conad".**

## Çështje për Gjykim nga Gjykata Administrative e Apelit

Në Gjykatën Administrative të Apelit, është gjykuar 1 (një) çështje:

Çështja Gjyqësore me:

Paditës: shoqëria "EKMA Albania" sh.p.k,


Të paditur: Autoriteti i Konkurrencës

Objekti:

1. Shfuqizimi i vendimit nr. 572, date 22.11.2018 "Për vendosje gjobe dhe detyrime ndaj ndërmarrjes "EKMA Albania" sh.p.k, në tregun e qiradhënies së ambienteve për magazinimin dhe tregtimin e produkteve Agro - Ushqimore në qytetin e Tiranës".

2. Marrjen e masës së sigurimit të padisë nëpërmjet pezullimit të vendimit të Autoritetit të Konkurrencës me nr. 572, datë 22.11.2018 "Për vendosje gjobe dhe detyrime ndaj ndërmarrjes "EKMA Albania" sh.p.k, në tregun e qiradhënies së ambienteve për magazinimin dhe tregtimin e produkteve Agro Ushqimore në qytetin e Tiranës" duke mos u vendosur nga ana e te paditurit asnjë gjobë deri në marrjen e vendimit të themelit mbi këtë padi.

**Gjykata Administrative e Apelit, më datë 18.06.2019, në dhomë këshillimi, vendosi rrëzimin e kërkesës për sigurimin e padisë nga ana e shoqërisë "EKMA Albania" SHPK, dhe pranimin e Ankimit të Autoritetit të Konkurrencës, duke i krijuar kështu mundësinë për ekzekutimin e gjobës dhe masave rregulluese.**



# Advokacia e Konkurrencës

## Konferenca “Konkurrenca dhe Sipërmarrja” 15 Vjetori i Autoritetit të Konkurrencës



### Tryeza të rrumbullakëta me temë: “Të njohim konkurrencën dhe sfidat e saj”

Në kuadër të rritjes dhe ndërgjegjësimit për një mjedis konkurrues, gjatë muajit nëntor 2019, u organizuan 2 tryeza të rrumbullakëta me titull “Të njohim konkurrencën dhe sfidat e saj”, me pjesëmarrje nga studentët e Universiteteve “Luigj Gurakuqi” në Shkodër më datë 11 Nëntor, dhe “Ismail Qemali” në Vlorë më datë 25 Nëntor.

Si përfitues i Projektit të BERZH “Asistencë teknike për AK, rritje e kapaciteteve, hartim i legjislacionit dhe Advokacia”, në zbatim të komponentit 1 të projektit “Strategjia për Advokacinë e Konkurrencës”, AK ka nisur hartimin e Strategjisë së Advokacisë.

Nëpërmjet projektit të Bashkimit Evropian, IPA 2015, IPA Twinning “Forcim kapacitetesh për AK për të mbrojtur konkurrencën e lirë dhe efektive në treg”, projekt binjakëzimi me Autoritetin Spanjoll të Konkurrencës (CNMC), në zbatim të komponentit 3, “Roli i AK për të bashkëpunuar me palë të ndryshme interesi”, do të zhvillojë seminare dhe takime me entet rregullatore dhe aktorë të ndryshëm të tregut në sektorë të ndryshëm të ekonomisë.



## Marrëveshje bashkëpunimi me institucione publike dhe ente rregullatore

Më datë 02.04.2019 u nënshkrua Memorandumi i Bashkëpunimit midis Autoritetit të Konkurrencës dhe Agjencisë së Prokurimeve Publike.



AGJENCIA E PROKURIMIT PUBLIK



# Bashkëpunimi ndërkombëtar

## Autoriteti Kroat i Konkurrencës:



Memorandum mirëkuptimi midis Autoritetit të Konkurrencës dhe Autoritetit Kroat të Konkurrencës, në datat 10-11 qershor 2019 në Zagreb.

## Autoriteti i Konkurrencës dhe i Mbrojtjes së Konsumatorit të Maltës



Vizitë më datë 26-27 shtator pranë Autoritetit të Konkurrencës dhe Mbrojtjes së Konsumatorit të Maltës në kuadër të Memorandumit të Mirëkuptimit të nënshkruar në Tiranë.

Në takimin me Drejtorinë e Konkurrencës, përfaqësuesit e Autoritetit Shqiptar të Konkurrencës u njohën nga afër me eksperiencën e një vendi anëtar të BE në lidhje me zbatimin e ligjit të konkurrencës, bashkëpunimin midis vendeve anëtare në kuadër të Rrjetit Evropian të Konkurrencës (ECN), harmonizimin e legjislacionit kombëtar me legjislacionin evropian, dhe veçanërisht me Direktivën ECN+.

## Konferenca e Kombeve të Bashkuara për Tregti dhe Zhvillim (UNCTAD)



Në datat 10-12 korrik 2019, në Gjenevë u organizua nga UNCTAD takimi i 18-të i "Grupit Ndërqeveritar të Ekspertëve mbi Konkurrencën, Ligjin dhe Politikën - IGE". Kryetarja e AK, Znj. Juliana Latifi, më datë 11 korrik, prezantoi mbi ecurinë dhe zhvillimet ndër vite të kapaciteteve institucionale të Autoritetit të Konkurrencës pas përfundimit të projektit të UNCTAD si dhe rolin e AK në rastet e konkurrencës që lidhen me ekonominë dixhitale.

## American Bar Association (ABA)



AK mori pjesë në sesionin e 67-të të Takimit Vjetor të Pranverës për Seksioni Antitrust Law në datat 26-29 mars 2019 në Washington DC, Shtetet e Bashkuara të Amerikës, organizuar nga American Bar Association.

## Organizata për Bashkëpunimin Ekonomik dhe Zhvillimin (OECD)



AK dha kontributin e saj në sesionin "Konkurrenca për tregun" në Forumin Global të Konkurrencës i cili u zhvillua në Paris në datat 5-6 dhjetor, ku paraqiti çështjen e koncesionit EMS-APO, çështje e cila u vlerësua si rast suksesi.

## Qendra Rajonale e Konkurrencës (OECD-GVH/RCC)



Gjatë vitit 2019, Autoriteti i Konkurrencës vijoi bashkëpunimin me OECD-GVH/RCC nëpërmjet trajnimeve të vazhdueshme që kjo qendër ofron për vendet e Evropës Qendrore, Lindore dhe Juglindore.

Trajnime të organizuara prej OECD-GVH/RCC, ku ka marrë pjesë AK:

11-13 Mars "Kufizimet në shitjet vertikale dhe E-commerce", Budapest, Hungari  
10-12 Shtator "Zbatimi i ligjit të Konkurrencës dhe Advokacia në sektorin Farmaceutik", Kiev, Ukrainë  
22-24 Tetor "Masat Rregulluese në Rastet e Konkurrencës", Budapest, Hungari  
10-12 Dhjetor "Konkurrenca në Sektorin e Energjisë", Budapest, Hungari

AK u përmend në newsletter-in e janarit 2019: Albanian Case in a Bid Rigging Procurement Procedure – Fight Against Corruption

## Rrjeti Ndërkombëtar i Konkurrencës (ICN)



AK, edhe gjatë vitit 2019, ka vijuar të jetë pjesëmarrëse e grupeve të ndryshme të punës, pjesë të International Competition Network, përkatësisht: Grupi i punës për avokacinë; Grupi i punës për efektivitetin e autoritetit; Grupi i punës për kartelet; Grupi i punës për përqendrimet; Grupi i punës për sjelljen e njëanshme në rastet e abuzimit të pozitës dominuese.

Më 4 Korrik, KK miratoi "Kornizën e Procedurave të Autoritetit të Konkurrencës (Competition Agency Procedures - CAP) në kuadër të Rrjetit Ndërkombëtar të Konkurrencës (ICN)".

Kjo kornizë ligjore lejon rritjen e mëtejshme të ndërveprimit dhe dialogut ndërmjet Autoriteteve të Konkurrencës, duke nxitur kështu konkurrencën e lirë dhe efektive në treg dhe duke thjeshtësuar funksionimin e duhur të saj.

## Komuniteti i Sekretariatit të Energjisë (ECS)



AK ishte pjesëmarrës në Forumin e 24-t të Komunitetit të Sekretariatit të Energjisë, i cili u zhvillua në datat 28-29 maj, në Athinë, Greqi.

# Integrimi Evropian



Procesi i integrimit përbën një nga prioritetet dhe sfidat e veprimtarisë së Autoritetit të Konkurrencës. Si një institucion lider për kapitullin e 8-të “Politika e konkurrencës dhe liberalizimi”, AK, gjatë vitit 2019 ka përmbushur misionin e tij, fokusuar në këto drejtime kryesore:

Në kuadër të PKIE në terma afatmesëm, për vitet 2017-2020 për kapitullin 8 “Politika e Konkurrencës”, AK, në respektim të afateve kohore, ka realizuar përafrimin e legjislacionit të konkurrencës me acquis të BE, nëpërmjet:

- Udhëzimi nr. 3, datë 26.06.2019 “Mbi miratimin e Udhëzuesit “Mbi dëmet që shkaktohen dhe veprimet që ndërmerren kur shkelen dispozitat e Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar””

AK si institucion lider i kapitullit 8 të MSA “Politika e konkurrencës”, gjatë procesit të pre-screening i cili u realizua gjatë takimit shpjegues “Explanatory Meeting” në Komisionin Evropian në datat 4-6 nëntor 2019, ku përfaqësues të DG Competition paraqitën kuadrin ligjor evropian në fushën e konkurrencës. Nga pala shqiptare ishin përfaqësues anëtarët e Grupit Ndërinstitucional të Punës për Integrimin Evropian për kapitullin 8 “Politika e konkurrencës”, ku bëjnë pjesë konkurrenca, ndihma shtetërore dhe liberalizimi.

Në vijim të fillimit të procesit të përgatitjes për Planin Kombëtar për Integrimin Evropian 2020-2022, të njoftuar nga Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, AK ka iniciuar punën në bashkëpunim me institucionet e tjera pjesë e Grupit Ndërinstitucional të Punës për Integrimin Evropian pjesë e kapitullit 8 “Politika e konkurrencës” me qëllim evidentimin e akteve relevante për t’u përfuar në periudhën 2020-2022 në fushën e konkurrencës si dhe duke marrë në konsideratë edhe fushat e ekspertizës së institucioneve të tjera pjesë e GNPIE.








# Kapacitete njerëzore

Gjatë vitit 2019, janë realizuar 32 trajnime jashtë vendit dhe 10 brenda vendit, ku është trajnuar një numër i konsiderueshëm prej **55 punonjësish** të institucionit, ku një pjesë e punonjësve rezultojn të jenë trajnuar më shumë se një herë.

Të gjitha trajnimet jashtë vendit janë **realizuar në kuadër të bashkëpunimit ndërkombëtar** të AK me OECD GVH/RCC. Ndërkohë që trajnimet brenda vendit janë kryer nga Shkolla e Administratës Publike, si dhe në ambientet e AK në kuadër të projektit të binjakëzimit IPA me Autoritetin Spanjoll për Tregjet dhe Konkurrencën.



# Prioritetet 2020



AK, në përputhje me qëllimin e ligjit nr. 9121/2003, për një konkurrencë të lirë dhe efektive në treg, do të vazhdojë mbikëqyrjen dhe hetimet kryesisht në tregjet me impakt të drejtpërdrejtë në interesat dhe mirëqenien e konsumatorit si:

Tregu i shërbimit të transportit ajror aeroporti TIA; tregu farmaceutik; tregu i shërbimit stomatologjik; tregu i gazit të lëngshëm (GLN); tregu i mikrokredisë (SFJB);

si dhe do të vazhdojë monitorimin dhe përfundimin e hetimeve lidhur me:

Telefoninë celulare  
Shërbimet spitalore  
Tregun Bankar  
Sektorin e arsimit të lartë  
Tregun e veprimtarive ekonomike të FSHF



## Përafrimi institucional me standardet dhe praktikat e BE-së

Gjatë vitit 2020, AK do të:

- Vazhdojë punën me amendimet ligjore (shtesa dhe ndryshime) të ligjit nr. 9121/2003 në përputhje me acquis të BE dhe problematikat e dala gjatë zbatimit të ligjit, si dhe rishikimin e kuadrit sekondar ligjor, në kuadër të implementimit të projektit IPA Twinning “Forcim kapacitetesh për AK për të mbrojtur konkurrencën e lirë dhe efektive në treg”.

- Hartojë “Strategjinë 5 vjeçare të advokacisë së konkurrencës”, në kuadër të implementimit të projektit të Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH), “Asistencë teknike për AK, rritje e kapaciteteve, hartim i legjislacionit dhe advokacia”.

- Sigurojë zbatimin e Kornizës së procedurave të AK (Competition Agency Procedures - CAP) në kuadër të Rrjetit Ndërkombëtar të Konkurrencës (ICN).

- Forcojë kapacitetet administrative, nëpërmjet trajnimit të stafit të ri si dhe atij ekzistues, me qëllim rritjen e cilësisë së monitorimit, inspektimit, hartimit të raporteve, analizave, si dhe cilësinë e mbrojtjes së vendimeve të KK në proceset gjyqësore, në të gjitha shkallët e tyre.

- Vazhdojë të zbatojë PKIE 2019-2020, për vitin 2020, dhe detyrat që rrjedhin nga MSA, si lider i kapitullit të 8-të “Politika e Konkurrencës”, ku do të punojë për përafrimin e akteve të mëposhtme:

• Udhëzimi i Komisionit Evropian (2002/C 165/03) mbi analizën e tregut dhe vlerësimin e fuqisë së konsiderueshme në treg, në kuadër rregullator të Komunitetit, për rrjetet dhe shërbimet e komunikimeve elektronike. (52002XC071102)

• Direktiva (EU) 2019/1 “Të fuqizojë autoritetet e konkurrencës së shteteve anëtare të BE-së për të qënë më efektive dhe të sigurojë mirëfunksionimin e tregut të brendshëm” (ECN +). (32019L0001)

- Angazhohet në rritjen e bashkëpunimit me institucione të tjera homologe dhe ente rregullatore duke nënshkruar me to edhe Memorandume Mirëkuptimi (MOU).



# Struktura organizative e AK



**AUTORITETI I  
KONKURRENCËS**

**Kryetari i  
Chairman of t**

**Kom  
The Com**

**Sekretari i R  
Secretary**

**Drejtoria e Shërbimeve  
Mbështetëse**

**Support Services  
Directorate**

**Drejtoria e Integritit dhe  
Komunikimit**

**Integration and  
Communication  
Directorate**

**Drejtoria Juridike dhe  
Çështjeve Gjyqësore**

**Legal and Judicial  
Affairs Directorate**

**Drej**

**M  
Met**

# The ACA organizational structure



COMPETITION  
AUTHORITY  
OF ALBANIA

